

VENDIM
Nr.454, datë 9.7.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË LAÇIT TË MJEDISEVE TË ISH-
REPARTIT USHTARAK NR.1022 NË LAÇ, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN
E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja "c", 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-repartit ushtarak nr.1022 në lagjen Sanxhak, Laç, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Laçit, për t'u përdorur në shërbim të komunitetit të këtij qyteti për nevoja arsimimi, mjedise spitalore dhe zyra pune.

2. Prona me numër rendor 772, "Ish-reparti ushtarak nr.1022", në lagjen Sanxhak, në Laç, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Laçit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Laçit të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano